



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 3733 Prot.

Elbasan më 30.07.2025

VENDIM

Nr 85 Datë 29.07.2025

" PËR
INDEKSIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË E
ELBASANIT"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar,
- Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr. 172/3, datë 21.04.2008,
- Udhëzimit të MTI nr. 1649, datë 16.08.1999, të përditësuar me udhëzimin nr. 14, datë 19.07.2007,

si dhe në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 8308, ku sanksionohet se:

"Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimet përkatëse",

si dhe se:

"Niveli dysheme i tarifave të shërbimit taksi nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus",

dhe mbështetur në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit, Sektori Licencimeve të Transportit,

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2025:

V E N D O S I:

Neni 1 – Miratimi i tarifave të reja

1.1. Të miratohen tarifat e reja të shërbimit të transportit me Taksi në Bashkinë Elbasan, sipas strukturës së përditësuar të pasqyruar në tabelën e mëposhtme të këtij vendimi.

Nr.	Përshkrimi	Tarifë (në lekë)
1	Tarifë bazë nisje (dita)	200
	Tarifë bazë nisje (nata)	250
2	Çmim për 1 km udhëtim brenda qytetit (dita)	90
3	Çmim për 1 km udhëtim brenda qytetit (nata)	100
4	Çmim për 1 km jashtë qytetit (dita)	70
	Çmim për 1 km jashtë qytetit (nata)	80

5	Tarifa pritjeje për 1 orë (dita)	500
	Tarifa pritjeje për 1 orë (nata)	700

Neni 2 – Zbatimi

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit - Sektori Licencimeve të Transportit për zbatimin e këtij vendimi dhe informimin e operatorëve të transportit dhe publikut për tarifat e reja.

Neni 3 – Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan.

KRYETARI

Lutfi Lala

3733/2

06.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 2481 prot.

Elbasan, më 6.8.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr. 95 datë 29.07.2025 “Për indeksimin e tarifave të shërbimit taksi në Bashkinë e Elbasanit”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ilir BEJTJA